

**SHEMBULLI SYNON TË KONKRETIZOJË ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 36, DATË 05.07.2013 “DISA RREGULLA MBI PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË STATISTIKA ZYRTARE”.**

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar ka ndërmarrë një fushatë inspektimi dhe mbikëqyrje në një institucion statistikor që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**INSTAT**” Tiranë me objekt zbatimin e ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në përpunimin e të dhënave personale gjatë Censurit 2011 lidhur me informimin e publikut, qëllimin, proporcionalitetin, cilësinë e të dhënave, të dhënat sensitive, përhapjen e të dhënave personale, transferimin ndërkombëtar, procedurat për bërjen anonime të të dhënave, ruajtjen, konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale të mbledhura gjatë këtij procesi.

Ky kontroll administrativ është realizuar në bashkëpunim edhe me ekspertët e huaj në kuadrin e Projektit IPA 2009 pranë Autoritetit të Komisionerit. Ky kontroll u ushtrua në dy faza pasi procesi i anonimizimit kërkonte kohë.

**Në përfundim të të dy inspektimeve u Rekomandua nga Komisioneri.**

**Rekomandim 1:**

Në zbatim të Rekomandimeve “*Për Censurin e popullsisë dhe banesave të vitit 2010* “ të dhëna nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me EUROSTAT-in, para zhvillimit të procesit të Censurit, në projektet pilot të përfshihet një pyetje për faktin se si reagojnë subjektet e të dhënave personale lidhur me të dhënat sensitive që kërkohen nga Censuri.

Në zbatim të Rekomandimeve “*Për Censurin e popullsisë dhe banesave të vitit 2010* “ të dhëna nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me EUROSTAT-in, në censurin e ardhshëm:

1. Shtetasve si subjekte të të dhënave personale t’u krijohen kushte që të plotësojnë vetë “*Pyetësorin e Censurit*”.
2. Të zbatohen mënyra të reja alternative për të mbledhur të dhënat e kërkuara për Censurin, përveç mënyrës aktuale (*pyetësorit aktual në letër*), sikurse mund të jetë mbledhja e tyre nëpërmjet internetit.
3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të të Dhënave Personale”, të hartohen procedura të brendshme dhe dokumente të shkruara ku të parashikohet në mënyrë specifike siguria, respektimi i konfidencialitetit dhe privatësisë së subjekteve të të dhënave personale.

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të të Dhënave Personale”, kontrolluesi të pajiset me çertifikata sigurie ndërkombëtare (si ISO 27000 etj.)

në mënyrë që të garantojë në mënyrë maksimale sigurinë e të dhënave personale që mbledh dhe përpunon gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

### **Rekomandim 2:**

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:

1. Të realizohen në një mënyrë transparente ndryshimet e kuadrit ligjor që të shërbejnë për procesin e anonimizimit të të dhënave personale që janë mbledhur gjatë Censurit-2011.
2. Të përcaktohen dhe miratohen procedurat e brendshme për procesin e anonimizimit, në pajtim me ligjin për Statistikat Zyrtare dhe ligjin për Censurin; të përfshihet një dispozitë se çfarë do të bëhet me kopjen “virtuale” të pyetësorit.
3. Të identifikohet me anë të një inventari çdo bazë të dhënash duke përfshirë një klasifikim të informacionit që përmbajnë: të dhëna personale, të dhëna jo personale (si psh. të dhëna të koduara) dhe informacion statistikor, informacion publik, informacion që mund të përhapet tek organet publike/private etj, duke pasur parasysh bazën ligjore që zbatohen për çdo rast.
4. Të përcaktohen dhe miratohen procedura të brendshme në pajtim me ligjin për Statistikat Zyrtare dhe ligjin për Censurin , për të parandaluar përhapjen e çdo të dhëne personale tek subjekte privatë apo publike në kundërshtim me ligjin.